

Informacion mbi procesin e integrimit evropian

Integrimi Evropian

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), në kuadër të përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian, ju informon mbi dokumentet, raportimet dhe vlerësimet që lidhen me përafrimin e legjislacionit dhe praktikave tatimore me *acquis* të Bashkimit Evropian, si më poshtë:

1. Dokumente strategjike për integrimin evropian

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022-2030
- Programi kombëtar për aderimin në Bashkimin Evropian 2024 – 2030
- Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE 2025-2027)
- Udhërrëfyesi (*roadmap*) për kapitullin 16: “Tatimet”, ku përfshihen 3 piketa mbyllëse:

1. Shqipëria ka korrigjuar të gjitha masat diskriminuese tatimore ndaj importeve të BE-së dhe nuk miraton masa të reja. Shqipëria ka një nivel të avancuar të përafrimit me *acquis* në fushat që kërkojnë përafrim të mëtejshëm, në veçanti tatimi direkt, TVSH-në, akcizat dhe taksimin e makinave. Në fushën e akcizës së energjisë, alkoolit dhe duhanit, ajo ndan me Komisionin dhe zbaton vazhdimisht një kalendar për një përafrim gradual me minimumin e BE-së.

2. Shqipëria demonstroi se ka kapacitet të mjaftueshëm administrativ me standarde të larta integriteti në administratën tatimore, si dhe infrastrukturën e nevojshme në zyrat e saj qendrore dhe lokale tatimore për të zbatuar legjislacionin e saj tatimor, për të mbledhur në mënyrë efektive tatimet dhe për të kontrolluar tatimpaguesit e saj. Shqipëria demonstroi se Zyra Qendrore Ndërlidhëse dhe Zyra Qendrore Ndërlidhëse e Akcizave kanë marrë masa të nevojshme për të siguruar që ato do të kenë staf të mjaftueshëm dhe operacional pas anëtarësimit.

3. Shqipëria demonstroi përparim të mjaftueshëm në zhvillimin e të gjitha sistemeve mbështetëse të IT-së të administratës tatimore, duke përfshirë ato që lidhen me ndërveprimin me sistemet përkatëse të BE-së, dhe në veçanti ato për TVSH-në (VIES, Rimbursimi i TVSH-së, One Stop Shop dhe Import One Stop Shop), akcizat (EMCS) dhe sistemet e saj mbështetëse dhe sistemet e IT-së të nevojshme për bashkëpunimin tatimor dhe shkëmbimin e informacionit në fushën e tatimit direkt.